



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI "A. XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
ELBASAN
ALBANIA
Tel& Fax.355 54 52593 Tel. 355 54 52782

Elbasan, më 03.03.2011

KËSHILLI I FAKULTETIT

**LËNDA: PROPOZIM PËR KRIJIMIN E NJËSISË BAZË TË EMËRTUAR “QENDRA E
STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE DHE BALLKANOLOGJIKE”**

SENATIT AKADEMIK TË UE “A.XHUVANI”

VENDIM

Nr. 56, datë 03.03.2011

**Për krijimin e një njësie bazë, të emërtuar Qendra e Studimeve Albanologjike dhe
Ballkanologjike**

Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë , Nr.9741, datë 21.5.2007, i ndryshuar me Nr.9832, datë 12.11.2007, Nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 8 pika 3, neni 10, pika 1 dhe 2, si dhe bazuar në statutin e UE “A.Xhuvani”, neni 1, pika 5, neni 15, pika b, Këshilli i Fakultetit të Shkencave Humane, në mbledhjen e datës 03.03.2011, vendosi të:

PROPOZOJË

- 1. Krijimin e njësisë bazë, të emërtuar Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike**
- 2. Organizimin dhe funksionimi i qendrës do të realizohet nga personeli akademik i departamenteve të FSHH-së**
- 3. Të miratojë emërimin e prof.as.dr. Kujtim Bevapi si drejtor i kësaj qendre**

Kryetari

Prof.dr. Roland Gjini

PROJEKTPROPOZIM

QENDRA KËRKIMORE E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE DHE BALLKANOLOGJIKE

I. Misioni dhe qëllimi

Qendra kërkimore e studimeve albanologjike dhe ballkanologjike (QSAB) krijohet pranë Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit "A.Xhuvani: të Elbasani, si një strukturë shkencore autonome me karakter ndërdisiplinor dhe ndërballkanik.

Qëllimi i QSAB-së është të nxisë kërkimet rreth dukurive me karakter shqiptar dhe me karakter të ballkanizuar përgjatë historisë, duke krijuar mundësi debati shkencor midis shkollave kombëtare të kërkimit në rajon dhe përfaqësuesve individualë të tyre.

QSAB-ja synon të veprojë në këto fusha: antropologji, arkeologji, histori, etnologji, folklor, gjuhë, letërsi, arti, qytetërim, besim dhe fusha të tjera.

QSAB-ja, ndër të tjera, do të ketë në përparësi hetimin e paraleleve ballkanike, dy- a më shumëpalëshe, konkordancat, bashkëpërkimet, ngjashmëritë, ndikimit, si dhe karakterin origjinal të cilësdo prej kulturave të rajonit.

Në këtë kontekst, QSAB-ja do të ndjekë si përparësi gjithashtu shtresimet me natyrë gjenetike dhe ato me natyrë historike, ndikimin e fqinjësisë dhe ndikimin e afërsisë.

II. Prirjet e studimit të QSAB-së:

Në fokusin e hulumtimeve të saj QSAB-ja do të studiojë veçmas ndikimet e kulturave të lashtësisë antike, të gjalla e të vdekura, duke përfshirë dhe ndikime të kulturave joballkanike (egjiptiane, hebraike, fenikase, etruske, mesdhetare).

QSAB-ja do të bëjë objekt studimit ndikimin e gjuhëve dhe kulturave të mëdha të liturgjisë: greqisht, latinisht, starosllavisht, si dhe ndikimin e gjuhëve të besimit islam (arabisht, osmanishte, persisht).

Kjo qendër kërkimore do të studiojë gjithashtu ndikimin e kulturave perandorake (romake, bizantine, osmane, austro-hungareze, ruse dhe të tjera).

Roli marrës dhe dhënës i kulturave të popujve të Ballkanit tek njëra-tjetra: albanizmat, helenizmat, sllavizmat, romanizmat dhe dukuri të tjera që kanë marrë fizionomi ballkanike, do të studiohen në autorësi individuale dhe të shumëfishtë.

Problemet e popullsive dygjuhëshe në Ballkan do të jenë gjithashtu në objektin e kërkimeve të kësaj qendre. Bashkësia gjuhësore ballkanike, dukuritë ndërkufitare, kulturat i ishullzuara, etnotipi dhe identiteti i kombeve të rajonit, ideologjitë dhe mitet kombëtare do të kenë rëndësinë e veçantë në studimet që do të ndërmerren në kuadrin e kësaj qendre.

Përparësi të padiskutueshme do të ketë niveli aktual i kulturave dhe qytetërimeve të popujve të Ballkanit, dukuritë poligjenetike dhe monogjenetike të tyre, dukuritë e reja të ndërveprimit midis tyre.

QSAB-ja do të organizojë ekspedita në terren, kërkime në arkiva, shkëmbime botimesh, nisma institucionale për probleme të pazgjidhura shkencore, konferenca, botime, ekspozita, promovime dhe veprimtari të tjera.

QSAB-ja do të ketë si qëllim studimin e dukurive kulturore shqiptare të shfaqura në hapësirën shqiptare gjatë shekullit të kaluar, nën ndikimin e faktorëve gjeopolitikë që realisht rezultuan veprues.

QSAB-ja do të ftojë për bashkëpunim qendra të ngjashme kërkimore brenda vendit dhe në vendet e tjera të Ballkanit dhe është e hapur për bashkëpunime të mundshme me rrethe të gjera studiuesish.

III. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese

Fakulteti apo një strukturë tjetër kërkimore	Fakulteti i Shkencave Humane në UE “A.Xhuvani”
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo institucione të tjera të arsimit të lartë	departamenti i gjuhës, letërsisë dhe i gazetarisë, departamenti i gjuhëve italiane dhe frënge, departamenti i gjuhëve angleze dhe gjermane, departamenti i histori-gjeografisë Qendra e Studimeve Albanologjike Universitete të tjera në Shqipëri
Institucione të huaja të arsimit të lartë	Universiteti i Prishtinës, i Tetovës etj.
Subjekte të tjera publike dhe private	

IV. Përbërja e qendrës dhe organet drejtuese

Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike do të funksionojë në tri seksione: i studimeve albanologjike, për trashëgiminë kulturore dhe ballkanologjike, me këtë organigramë:

1. Sektori i studimeve albanologjike

Kryetar prof.as.dr. Kujtim Bevapi
Anëtar prof.dr. Roland Gjini
Anëtar prof.dr. Emine Sadiku
Anëtar dr. Albert Riska
Anëtar prof.as.dr. Tomor Plangarica

2. Sektori i studimeve për trashëgiminë kulturore

Kryetar prof.as.dr. Ylli Cerova

Anëtar prof.as.dr. Hysen Shabanaj
Anëtar prof.dr. Vilson Kuri
Anëtar prof.dr. Arqile Bërxfholi
Anëtar Riza Hasa

3. Sektori i studimeve ballkanologjike

Kryetar prof.as.dr. Blerina Suta
Anëtar prof.dr. Roland Gjini
Anëtar prof.as.dr. Liman Varoshi
Anëtar dr. Albert Riska
Anëtar Majlinda Peza

Drejtor i Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike pranë Fakultetit të Shkencave Humane të UE “A.Xhuvani” është prof.as.dr. Kujtim Bevapi

Sekretar i QSAB-së .

.....

V. RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË QSAB-SË

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike (më tej QSAB) është njësi bazë e ngritur pranë Fakultetit të Shkencave Humane të UE “A.Xhuvani”, sipas Ligjit të arsimit të lartë , Nr.9741, datë 21.5.2007, i ndryshuar me Nr.9832, datë 12.11.2007, Nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 8 pika 3.

1. QSAB është krijuar në kuadrin e reformimit të sistemit arsimor e shkencor publik, me propozim të Këshillit të Fakultetit dhe vendim të senatit të UE “A.Xhuvani”, pranë Fakultetit të Shkencave Humane.
2. Data e themelimit të QSAB-së është më
3. Stema dhe logoja e QSAB-së figurojnë në aneksin bashkëlidhur me këtë Statut.

Neni 2

QSAB është qendër kërkimore pranë FSHH-së, që merret me punë kërkimore-shkencore, që përfshin në organizimin e saj sektorë shkencore dhe grupe kërkimore, të cilët kanë për qëllim zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat e shkencave albanologjike dhe ballkanologjike.

Neni 3

QSAB kryen kërkimin e thelluar shkencor, përfshihet në formimin pasuniversitar të studentëve dhe të kërkuesve, si dhe shërbime e transferime të njohurive në fushat e identitetit, të kulturës, të pasurisë materiale e shpirtërore dhe të historisë së botës shqiptare.

Neni 4

Arritjet e veprimtarisë kërkimore-shkencore të QSAB dhe frytet e kësaj veprimtarie vihen në shërbim të shoqërisë, si dhe në shërbim të zhvillimit të mëtejshëm të institucionit dhe të kualifikimit të vazhdueshëm të punonjësve shkencorë e të studentëve.

KREU II

MISIONI, DETYRAT, FUNKSIONIMI

Neni 5

QSAB i përmbahet këtij misioni:

1. Kryen kërkime dhe studime me karakter teorik dhe zbatues në fusha të ndryshme të shkencave albanologjike e ballkanologjike dhe kujdeset për përhapjen dhe për zbatimin e tyre;
2. Kujdeset për të hapur fusha të reja kërkimesh e studimesh shkencore, në përputhje me nevojat e zhvillimit vendor e më gjerë;
3. Mbështet dhe bashkëpunon në studimet e nivelit të dytë e të tretë që ofrohen pranë FSHH-së në fushat e shkencave albanologjike, ballkanologjike dhe trashëgimisë kulturore.
4. Bashkëpunon me institucione homologe, me universitete dhe me qendra të tjera shkencore, publike e private, vendore, rajonale e ndërkombëtare;
5. Përkrah dhe nxit bashkëpunimin me shoqata, fondacione, organizata dhe individë, në të mirë të zhvillimit të shkencave albanologjike e ballkanologjike;

Neni 6

Detyrat

QSAB përmbush me përparësi këto detyra:

1. Përpunon mendimin shkencor të përparuar, që t'u paraprijë zhvillimeve shoqërore e kulturore, si dhe të shërbejë si një mbështetje e fuqishme për hartimin dhe përpunimin e projekteve hulumtuese në fushat e albanologjisë e ballkanologjisë;
2. Kujdeset për përhapjen e dijeve dhe të vlerave të kërkimit shkencor, nëpërmjet mediatizimit të tyre, si dhe nëpërmjet formave të tjera të transmetimit të informacionit;
3. Punon për mbledhjen dhe për studimin e materialeve burimore, për klasifikimin dhe për arkivimin e tyre, si dhe kujdeset për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e tyre.
4. Transmeton dijet e fituara nga kërkimi shkencor te studentët dhe te kërkuesit e rinj, nëpërmjet formimeve të thelluara.

Neni 7

Funksionimi

1. Në funksionimin e saj, QSAB udhëhiqet nga parimi i lirisë akademike: ajo garanton dhe mbron lirinë e opinionit dhe të ideve, si kusht themelor për zhvillimin e mendimit kritik e krijues, në kërkimin shkencor dhe në formimin e thelluar.
2. QSAB respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore.
3. Veprimtaria financiare dhe administrative e QSAB realizohet përmes administratë qendrore të Universitetit "Aleksandër Xuvani" të Elbasanit (UE).
4. Statusi i personelit drejtues të QSAB është i njëjtë me atë të departamentit, sinjësi bazë e Fakultetit të shkencave humane të UE.

Neni 8

Veprimtaria

1. QSAB e zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të programeve kërkimore e të projekteve shkencore vjetore dhe shumëvjeçare.
2. QSAB bashkëpunon me universitete dhe me institucione të tjera të arsimit të lartë të vendit, duke synuar integrimin sa më efektiv të punës kërkimore e pedagogjike në shkallë kombëtare. Ky bashkëpunim kryhet në mënyrë të institucionalizuar, në bazë të marrëveshjeve, për të realizuar pjesëmarrjen e punonjësve shkencorë në procesin mësimor, përfshirjen e tyre në projekte e programe të përbashkëta kërkimore-shkencore dhe shfrytëzimin e ndërsjellë të arkivave, bibliotekave dhe pajisjeve shkencore.
3. QSAB vendos dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe universitare rajonale e ndërkombëtare. Ajo ndihmon në bashkërendimin e veprimtarisë së grupeve kërkimore dhe të punonjësve të saj shkencorë me institucione shkencore dhe organizma ndërkombëtare, për arritjen e një integrimi sa më të frytshëm të kërkimit shkencor shqiptar në shkencën botërore.
4. QSAB anëtarësohet në organizma të përhershme ose të përkohshme të kërkimit shkencor dhe akademik në rang vendor, rajonal e ndërkombëtar.

Neni 9

Për realizimin e misionit dhe të detyrave të saj, QSAB:

1. Kërkon financimin dhe harton projekte për ngritje fondesh për realizimin e programeve të veçanta të kërkimit shkencor, të ndërmarra me nismën e sektorëve kërkimorë ose të punonjësve kërkimorë të QSAB, pas miratimit të tyre në organet drejtuese dhe kolegjinale të përcaktuara në këtë Statut;
2. Organizon veprimtari shkencore në shkallë lokale, kombëtare e ndërkombëtare;
3. Organizon këshillime shkencore, mbledhje e takime të tjera pune, për shqyrtimin dhe trajtimin e çështjeve të caktuara;
4. Boton rezultatet e punës shkencore të saj, si monografi shkencore, vëllime me dokumente, kolana studimore dhe vepra të tjera me vlerë shkencore; të studiuesve të saj, si dhe të autoriteteve shkencore të vendit e të huaj;
5. Organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore;
6. Pasuron periodikisht, mirëmban dhe vë në dispozicion të publikut bibliotekën, arkivat dhe fondet shkencore albanologjike, duke ndjekur një politikë elastike për thithjen e financimeve publike, private e ndërkombëtare.

<p style="text-align: center;">KREU III ORGANET DREJTUESE</p>

Neni 10

Organet drejtuese të QSAB janë:

- a) Dekani
- b) Drejtori i qendrës
- c) Bordi i qendrës (përgjegjësit e sektorëve kërkimorë)
- ç) Këshilli i Fakultetit të Shkencave Humane

BORDI I QENDRËS

Neni 11

Funksionet e sektorit kërkimor

1. Bordi kërkimor është organ kolegjal vendimmarrës, që përcakton politikat e zhvillimit të qendrës, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e kërkimit shkencor e të mësimdhënies dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
2. Bordi kryesohet nga drejtori i QSAB dhe mblidhet periodikisht.
3. Funksionet kryesore të bordit janë:
 - a) garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e punonjësve shkencorë e të studentëve;
 - b) miraton planin disavjeçar të zhvillimit të qendrës dhe programin vjetor të veprimtarive të saj;
 - c) vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e qendrës, pasi merr miratimin nga Këshilli i Fakultetit e më pas nga senati i UE;
 - ç) miraton ndarjen e burimeve financiare;
 - d) miraton projektstatutin e qendrës me dy të tretat e votave të anëtarëve të saj;
 - dh) miraton rregulloret e qendrës, që janë kompetencë e tij;
 - e) vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit e zhvillimit dhe hapjen, ndryshimin ose mbylljen e sektorëve kërkimorë-shkencorë;
 - f) miraton projektet e marrëveshjeve apo kontratave të bashkëpunimit me të tretë, të cilat i nënshkruan Drejtori në emër dhe për llogari të QSAB;
 - g) vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në qendër, në përputhje me standardet shtetërore e ndërkombëtare;
 - gj) miraton raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore-shkencore si dhe atë financiar, në një mbledhje të hapur për gjithë personelin akademik e administrativ, si dhe për studentët.
4. Bordi kërkon mendimin e Këshillit të Fakultetit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit.

Neni 12

Përbërja e bordit

1. Anëtarët e bordit zgjidhen me propozim të dekanit dhe miratim të këshillave shkencorë të departamenteve të QSAB-së, në përputhje me ligjin dhe sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e QSAB.

2. Bordi përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë, konkretisht:
 - a) Dekani i FSHH-së
 - b) Drejtori i QSAB, i cili është dhe Kryetari i Bordit;
 - c) 3 drejtuesit e sektorëve kërkimorë të QSAB;
3. Bordi zgjedh, nga anëtarët e tij, nëndrejtorin.

Neni 13

Mandati i bordit dhe i anëtarëve të tij

1. Bordi, si organ kolegjal, ka mandat 4-vjeçar.
2. Mandati i anëtarit të bordit fillon nga çasti i zgjedhjes dhe zgjat deri në përfundim të mandatit të bordit.
3. Mandati i anëtarit të bordit konsiderohet i përfunduar në mënyrë të parakohshme në rastet kur anëtari:
 - a) jep dorëheqjen si anëtar i bordit;
 - b) përfundon marrëdhëniet e punës me universitetin;
 - c) nuk merr pjesë në më shumë se gjysmën e mbledhjeve të zhvilluara gjatë një viti akademik;
 - ç) dënohet për një vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) bëhet i pamundur nga ana fizike ose mendore të ushtrojë funksionin.
4. Vendi vakant i krijuar nga përfundimi në mënyrë të parakohshme i mandatit të një anëtari të bordit plotësohet me një person tjetër të zgjedhur nga i njëjti grup i anëtarëve të QSAB-së, sipas rendit në listën e konkurrimit.

Neni 14

Mbledhja e parë e bordit

1. Në mbledhjen e tij të parë, bordi thirret nga Drejtori i QSAB-së.
2. Në këtë mbledhje zgjidhet Zëvendësdrejtori i bordit, nga radhët e anëtarëve. Zgjedhja e Zëvendësdrejtorit bëhet edhe në rastet e mbarimit të mandatit në mënyrë të parakohshme të anëtarit të zgjedhur nëndrejtor, apo kur Zëvendësdrejtori jep dorëheqjen nga kjo detyrë.
3. Nënkyetari propozohet nga Kryetari i bordit dhe zgjidhet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të bordit.
4. Në mbledhjen e tij të parë bordi miraton propozimin e Drejtorit për emërimin e Zëvendësdrejtorit të QSAB-së.

Neni 15

Thirrja e mbledhjes së bordit drejtues

1. Bordi mblidhet në mënyrë periodike, si rregull një herë në dy muaj.
2. Mbledhja e bordit thirret:

- a) Nga Dekani i FSHH-së
- b) nga Drejtori i QSAB (Kryetari i bordit);
- c) nga anëtarë të bordit, të cilët përbëjnë të paktën $\frac{1}{4}$ e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

3. Mbledhja thirret nëpërmjet njoftimit me shkrim të rendit të ditës, 7 ditë para datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes. Së bashku me njoftimin për rendin e ditës, thirrësit e mbledhjes njoftojnë edhe materialet mbi çështjet që do të shqyrtohen në mbledhje. Njoftimi i rendit të ditës dhe i materialeve bëhet me protokoll, në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit.

Neni 16

Vlefshmëria e mbledhjes dhe e vendimeve të bordit të qendrës

1. Mbledhjet e bordit të qendrës drejtohen nga drejtori. Nëndrejtori drejton mbledhjet e bordit në rast të mungesës së drejtorit.
2. Mbledhjet e bordit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se $\frac{2}{3}$ e anëtarëve të tij. Në rast se në mbledhje janë të pranishëm më pak se $\frac{2}{3}$ e anëtarëve, mbledhja shtyhet për një datë tjetër, jo më vonë se tetë ditë.
3. Anëtarët e bordit e ushtrojnë vetë funksionin e tyre. Ata nuk mund t'ia delegojnë votën një anëtari tjetër dhe as të votojnë në emër të një anëtari tjetër të bordit.
4. Votimi në bord, si rregull, është i hapur. Në rastet kur vendimi për të cilin do të votohet u referohet personave të përveçëm, bordi mund të vendosë me shumicë të thjeshtë për të zhvilluar votim të fshehtë. Procedurat për zhvillimin e votimit të fshehtë përcaktohen nga bordi.
5. Vendimet e bordit, si rregull, kalojnë për shqyrtim në Këshillin e Fakultetit dhe miratohen prej tij.
6. Bordi, me propozimin e drejtorit, cakton sekretarinë teknike, si një strukturë *ad hoc*, e cila përbëhet nga të paktën një person për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

Neni 17

Zbardhja, nënshkrimi dhe publikimi i vendimeve të bordit

1. Vendimet e marra nga bordi zbardhen brenda ditës së nesërme të mbledhjes në të cilën vendimi është miratuar dhe i përcillen Këshillit të Fakultetit dhe dekanatit.
2. Vendimet e Senatit Akademik nënshkruhen nga drejtori i qendrës, pas zbardhjes së procesverbalit të mbledhjes.

DREJTORIA

Neni 18

Përbërja e Drejtorisë së QSAB-së

Drejtoria e QSAB-së është organ kolegjal ekzekutiv. Drejtoria përbëhet nga:

- a) Drejtori;

- b) Nëndrejtori;
- c) Përgjegjësit e sektorëve;

Neni 19

Funksionet dhe detyrat

Funksionet e Drejtorisë janë si më poshtë:

- a) harton planin disavjeçar të zhvillimit;
- b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Bord e Këshillin e Fakultetit;
- c) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
- d) harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në këshillin e fakultetit;
- e) paraqet rekomandime për projektet shkencore, për programet e studimeve dhe për kërkimin shkencor, si dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
- ë) zbaton vendimet e miratuara nga bordi i QSAB dhe Këshilli i Fakultetit;
- f) monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të QSAB-së;
- g) ndjek veprimtarinë në sektorë të QSAB-së për përmbushjen e qëllimeve të qendrës si dhe për zbatimin e akteve të organeve drejtuese të QSAB-së;
- gj) raporton dy herë në vit në Këshillin e Fakultetit, ose sa herë e kërkon dekani;
- h) harton raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore-mësimore dhe financiare dhe ia paraqet atë për miratim bordit dhe Këshillit të Fakultetit, brenda datës 20 janar të çdo viti;
- i) mund t'ia delegojë kompetencat personelit apo një organi tjetër të institucionit, në përputhje me rregulloren e vet;
- j) propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
- l) përgatit rregulloren e vet të punës, që miratohet nga bordi, përgatit përshkrimet e punës për pozicionet e kërkuesve në QSAB.
- ll) merr vendime në përputhje me kompetencat e veta.

Neni 20

Mbledhjet dhe vendimmarrja

1. Drejtorja mblidhet, si rregull, jo më pak se një herë në dy muaj. Në raste të nevojshme Drejtorja mund të mblidhet në çdo kohë, me kusht që të lihet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e materialeve që lidhen me çështjet për diskutim.
2. Mbledhja thirret nga Drejtori, kryesisht apo me kërkesën e secilit prej anëtarëve të Drejtorisë. Mbledhja konsiderohet e vlefshme nëse në të marrin pjesë dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Drejtorisë.
3. Si rregull, Drejtorja merr vendime njëzëri. Kur kjo nuk është e mundur, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të Drejtorisë. Në të gjitha rastet kur votimi bëhet i domosdoshëm, vota e anëtarëve të Drejtorisë është e fshehtë. Kur nuk mund të arrihet shumica, vota e Drejtorit është përcaktuese.
4. Procesverbali i mbajtur në mbledhjen e Drejtorisë përbën dokumentin bazë për pasqyrimin e vendimmarrjes.

Neni 21

Kodi i Etikës

1. Kodi i etikës së qendrës është dokumenti i miratuar nga senati i UE “A.Xhuvani” për gjithë institucionin.

SEKTORI SHKENCOR I QENDRËS

Neni 22

Funksionet

1. Sektori shkencor i qendrës është organ kërkimor vendimmarrës në kuadër të qendrës.
2. Sektori shkencor i qendrës ka këto funksione:
 - a) programon e përcakton, në bazë të propozimeve të anëtarëve dhe departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore e materiale në dispozicion të qendrës;
 - b) propozon programe të reja të kërkimit shkencor ose programe të reja studimi në FSHH;
 - c) shqyrton dhe miraton raportin vjetor të Drejtorit të qendrës për veprimtarinë kërkimore-shkencore;
 - dh) i propozon bordit planin strategjik të zhvillimit të për fushat që mbulon dhe mbikëqyr realizimin e tij.
3. Sektori kërkimor kryesohet nga përgjegjësi i sektorit.
4. Përgjegjësi i sektorit emërohet nga bordi drejtues me propozim të drejtorit të qendrës.

Neni 23

Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve

1. Sektori kërkimor i qendrës përbëhet nga 5 anëtarë. Ndarja e anëtarëve në sektorin shkencor të qendrës bëhet si më poshtë:
 - a) përgjegjësi i sektorit;
 - b) anëtarë nga personeli akademik i qendrës;
2. Anëtarët e sektorit shkencor të qendrës kanë së paku gradën “Doktor”.
3. Anëtarët e sektorit shkencor të qendrës zgjidhen nga grupet përkatëse të anëtarëve të qendrës, në përputhje me rregulloren e QSAB-së.

Neni 24

Mbledhjet dhe vendimmarrja

1. Sektori shkencor i qendrës thirret në mbledhje nga Drejtori i qendrës, apo nga të paktën tre anëtarë të tij.
2. Thirrja e mbledhjes bëhet duke njoftuar, të paktën 3 ditë para, rendin e ditës dhe materialet e mbledhjes.

3. Mbledhja e sektorit shkencor të qendrës quhet e vlefshme kur në të marrin pjesë së paku 3 anëtarë të tij. Në rast të mos formimit të numrit të nevojshëm, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më shumë se dy ditë pune.

4. Si rregull, vendimet e sektorit shkencor të qendrës bëhen me votim dhe merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

KREU IV AUTORITETET DREJTUESE
--

Neni 25

Drejtori

Drejtori i QSAB-së është autoriteti drejtues, i cili e përfaqëson qendrën dhe vepron në emër dhe për llogari të saj.

Drejtori i QSAB-së ka këto detyra dhe të drejta:

1. Siguron lidhjet me dekanatin e FSHH-së, thërret dhe drejton mbledhjet e bordit drejtues dhe të Drejtorisë së QSAB-së;
2. Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e të gjitha strukturave të QSAB-së;
3. Në rast shkeljeje flagrante të ligjit dhe të akteve nënligjore nga një autoritet drejtues i një njësie kryesore, ka të drejtë t'i referohet nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
4. Garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit dhe të rregulloreve të brendshme të QSAB-së;
5. Cakton delegacionet e përfaqësimit institucional dhe miraton projektet dhe planet e specializimit jashtë shtetit të kërkuesve shkencorë dhe të personelit administrativ;
6. Paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë të bordit drejtues;
7. Emëron dhe shkarkon Nëndrejtorin e QSAB-së me miratimin e bordit drejtues, propozon përgjegjësin e sektorit kërkimor dhe ia paraqet për miratim bordit;
8. Ngre komisione e grupe pune për çështje, studime dhe veprimtari të veçanta;
9. Ka të drejtë të thërrasë në konsultë një bord këshillimor, sipas fushave specifike, të përbërë nga ekspertë vendas apo të huaj; mënyra e shpërblimit të anëtarëve të këtij bordi përcaktohet me vendim të Senatit Akademik të UE "A.Xhuvani";
10. Nënshkruan në emër të QSAB-së marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione kërkimore, institute, universitete dhe institucione të tjera homologe brenda e jashtë vendit; nënshkruan protokollin e anëtarësimit të QSAB-së në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë ose të tjera; nënshkruan dokumentacionin e bashkëpunimit me organizata joqeveritare e donatorë vendas apo të huaj që ndihmojnë në zhvillimin e kërkimit shkencor në QSAB;
11. Zgjedhja e drejtorit të qendrës kërkimore bëhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik përkatës, në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë, nr.9741.

12. Mandati i Drejtorit mbaron kur:

- a) përfundon afati i mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrrojë funksionin;
- ç) në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore, pezullohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës sipas nenit 64, pika 3, të Ligjit për Arsimin e Lartë.

Neni 26

Nëndrejtori

1. Nëndrejtori emërohet nga Drejtori i QSAB-së, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej këtij në bordin drejtues. Bordi miraton propozimin e paraqitur nga Drejtori, në mbledhjen e tij të parë.
2. Nëndrejtori ushtron këto detyra:
 - a) Zëvendëson Drejtorin në raste të mungesës së tij, me autorizim të këtij të fundit;
 - b) Organizon dhe kontrollon punën kërkimore-shkencore në QSAB;
 - c) Ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve e të programeve kërkimore e mësimore në qendër dhe në sektorë;
 - ç) Kontrollon dhe përgjithëson përvojën e sektorëve dhe të njësive të QSAB-së;
 - d) Ndjek bashkëpunimin shkencor të njësive të QSAB-së me institucione shkencore, universitete etj.;
 - e) Kryen detyra të tjera, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në këtë Statut apo në akte të tjera.
3. Nëndrejtori largohet nga detyra:
 - a) Kur jep dorëheqjen;
 - b) Kur shkarkohet nga Drejtori i QSAB-së për shkelje të akteve ligjore e nënligjore, apo kur me veprimet a mosveprimet e tij cenon veprimtarinë e QSAB-së;
 - c) Kur për arsye fizike apo mendore konstatohet pamundësia në kryerjen e detyrave të ngarkuara;
 - ç) Kur dënohet me vendim gjykate për kryerjen e një vepre penale.
4. Nëndrejtori i QSAB-së shkarkohet nga Drejtori, duke ndjekur të njëjtat procedura si për emërimin e tij. Në rast shkarkimi të Nëndrejtorit, Drejtori, brenda 10 ditëve, i propozon bordit drejtues kandidaturat për Nëndrejtorin e ri.

KREU V

ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Njësiti përbërës

Neni 27

1. QSAB përbëhet nga këto njësi kryesore:
 - a) sektori i albanologjisë;

- b) sektori i ballkanologjisë;
- c) sektori i trashëgimisë kulturore;

SEKTORËT E QSAB-së

Neni 28

Përcaktimi

1. Në sistemin e QSAB-së bëjnë pjesë sektorë kërkimorë-shkencorë, që kryejnë kërkime themelore dhe zbatuese në fushat e shkencave albanologjike e ballkanologjike.
2. Sektori është njësi që bashkërendon kërkimin shkencor dhe formimin e thelluar në fushën e tij të ekspertizës, si dhe në fusha të përafërta ose të ndërthurura.
3. Misioni kryesor i çdo sektori të QSAB-së përputhet me misionin dhe detyrat parësore të QSAB-së.

MEDIATEKA ALBANOLOGJIKE E BALLKANOLOGJIKE

Neni 29

Funksionimi

1. Pranë QSAB-së funksionon mediateka albanologjike e ballkanologjike, në cilësinë e një njësie ndihmëse.
2. Mediateka albanologjike e ballkanologjike drejtohet nga përgjegjësi i Mediatekës (ose laboranti i saj).
3. Përgjegjësi i Mediatekës emërohet në funksion nga dekani i FSHH-së me propozim të drejtorit të QSAB-së si personel ndihmës mësimor-shkencor.
4. Mediateka albanologjike e ballkanologjike përbëhet nga 3 sektorë:
 - a) Biblioteka albanologjike e ballkanologjike: përbëhet nga inventarët e prurjet bibliotekare nga burime të ndryshme.
 - b) Arkivi albanologjik e ballkanologjik: përbëhet nga koleksionet e arkivave shkencorë, të tipologjive të ndryshme, si dokumente të shkruara, materiale ekspeditash, dorëshkrime e përkthime, skedarë e kartoteka, audiotekë, vidiotekë, fototekë, skicotekë etj.
 - c) Fondet albanologjike e ballkanologjike: përbëhen nga fondet materiale të etnografisë dhe të arkeologjisë, si dhe nga fondi numizmatik, që janë një pasuri e pazëvendësueshme për trashëgiminë historike e kulturore shqiptare.

Neni 30

Administrimi

1. Sektorët e mediatekës albanologjike e ballkanologjike drejtohen nga përgjegjësit e sektorëve kërkimorë të qendrës.

2. Mediateka albanologjike e ballkanologjike funksionon sipas Ligjit për Arkivat dhe për Bibliotekat, sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe sipas një rregulloreje të veçantë.

Neni 31

Detyrat

1. Mediateka albanologjike e ballkanologjike administron dhe mirëmban literaturën dhe arkivat shkencorë që nevojiten për studimet albanologjike e ballkanologjike dhe fushat studimore që lidhen me këto.
2. Mediateka albanologjike e ballkanologjike me sektorët e saj kujdeset për ruajtjen dhe përdorimin e materialeve bibliotekare, arkivore dhe të fondeve, duke zbatuar metoda të përparuara shkencore për konservimin, restaurimin, katalogimin, mediatizimin dhe shfrytëzimin e tyre.
3. Mediateka albanologjike e ballkanologjike i propozon Drejtorit të QSAB-së për të vendosur lidhje me biblioteka dhe arkiva shkencore brenda e jashtë vendit, publike e private, për shkëmbim e për pasurim literature dhe fondesh arkivore.
4. Mediateka albanologjike e ballkanologjike vendos bashkëpunim të ngushtë, në nivel specialistësh dhe strukturash, me Ministrinë e Kulturës dhe strukturat e saj, siç janë Muzeu Historik Kombëtar, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Qendra Kombëtare e Inventarizimeve, etj.

KREU VI

KËRKIMI SHKENCOR

Neni 32

Financimi i kërkimit shkencor

1. Veprimtaria financiare dhe administrative e QSAB-së realizohet në varësi të rektoratit të UE “A.Xhuvani” nëpërmjet drejtorisë ekonomike.
2. Drejtori i QSAB-së është personel akademik i fakultetit që kryen veprimtari mësimore dhe shkencore në përputhje me statusin e tij, me mësimdhënie të normuar vjetore të parashikuar nga Udhëzimi Nr.20, datë 09.05.2008, MASH-it.
3. QSAB financohet nga rektorati i UE “A.Xhuvani”, me të ardhura të krijuara nga vetë institucioni, si dhe me burime të tjera të ligjshme.
4. QSAB përfiton, në bazë të konkurrencës, nga programi i financimit shtetëror të projekteve për kërkim shkencor.
5. QSAB mund të përfitojë financime nga subjekte private të interesuara për kërkimin shkencor dhe ofron shërbime brenda fushave të veprimtarisë së saj.
6. Personeli akademik i QSAB, si dhe studentët e ciklit të tretë, kanë të drejtë të aplikojnë për fonde nga buxheti i institucionit, për kërkimin shkencor.

7. Kriteret për përfitimin e financimeve për çdo vit, miratohen nga Senati Akademik i UE-së dhe shpallen nga Drejtoria e QSAB-së.
8. Me përfituesit e këtyre financimeve lidhet një kontratë e posaçme, në të cilën parashikohen të drejtat dhe detyrimet mes tyre dhe QSAB.

Neni 33

Botimet shkencore

1. Botimet Shkencore të QSAB-së realizohen nëpërmjet Këshillave Shkencorë të sektorëve dhe Këshillit Botues të QSAB-së.
2. Këshillat Shkencorë të sektorëve i propozojnë Këshillit Botues të QSAB-së veprat e miratuara prej tyre për botim, në përputhje me procedurën e parashikuar në rregulloren e sektorit, duke i renditur ato sipas përparësisë.
3. Këshilli Botues i QSAB-së ka si funksion kryesor nxitjen, bashkërendimin, zhvillimin dhe realizimin e punës botuese të personelit akademik dhe të qendrës. Ai vlerëson për botim përfundimtar veprat e miratuara në Këshillat Shkencorë të sektorëve dhe ato që dalin me siglën e QSAB-së, në përputhje me mundësitë financiare botuese të QSAB-së.
4. Këshilli Botues i QSAB-së përbëhet nga 5 anëtarë dhe kryesohet nga Drejtori i QSAB-së. Anëtarë të tjerë të Këshillit Botues të QSAB-së janë: Nëndrejtori i QSAB-së, koordinatori shkencor i QSAB-së, dy punonjës shkencorë të QSAB-së.

Neni 34

Kërkimi shkencor me ose për të tretët

1. Sektorët u ofrojnë të tretëve ose pranojnë oferta për kërkim shkencor, ekspertizë shkencore e shërbime të tjera, duke ndjekur procedurat e miratimit dhe duke kontribuar financiarisht sipas marrëveshjeve dhe në përputhje me Rregulloren.
2. Kur nga kërkimi shkencor apo shërbimet për të tretët krijohen të ardhura, ato ndahen mes sektorit që ofron shërbimin dhe personelit të përfshirë në të, sipas marrëveshjes dhe në përputhje me rregullat financiare të secilit institucion.

KREU VII

PERSONELI I QSAB-së

Neni 35

Përbërja

1. Personeli i QSAB-së përbëhet nga:
 - a) Personel akademik;
 - b) Personel ndihmës kërkimor-shkencor,
 - c) Personel administrativ.
2. Personeli akademik përbëhet nga punonjës me titull akademik e shkencor:

- a) Akademik
 - b) Profesor-Doktor
 - c) Profesor i Asociuar
 - ç) Doktor
 - d) Docent ose Doktorant
3. Personeli ndihmës kërkimor-shkencor përbëhet nga:
- a) Kërkues me arsim të lartë
 - b) Specialist me arsim të lartë
 - c) Specialist me arsim të mesëm
4. Pjesë e personelit administrativ janë drejtuesit dhe punonjësit tekniko-administrativë, të cilët nuk bëjnë pjesë në njërin nga sektorët e QSAB-së.
5. Personeli akademik, personeli ndihmës kërkimor-shkencor dhe personeli administrativ i fillojnë dhe i përfundojnë marrëdhëniet e punës në mënyrën e përcaktuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, në Kodin e Punës dhe në pikat e posaçme të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 36

Detyrat dhe të drejtat e personelit akademik

Personeli akademik, ose punonjësi shkencor i QSAB-së, ka këto detyra dhe të drejta:

- a) Të punojë për ngritjen e tij profesionale, akademike e shkencore;
- b) Të parashtojë në sektor ose në bordin drejtues probleme që lidhen me të ardhmen e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit të shkencës e të institucionit;
- ç) Të referojë periodikisht në organizmat e fushës përkatëse shkencore dhe në grup specialistësh për arritjet në fushën e tij studimore dhe në veprimtarinë e tij;
- c) Të kontribuojë drejtpërdrejt me veprimtarinë e tij vetjake, ose me cilësinë e tij si drejtues grupesh a projektsh shkencore, brenda dhe jashtë QSAB-së, në studimin dhe në zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të shkencës albanologjike e ballkanologjike;
- dh) Të marrë pjesë në organizmat e ndryshme që funksionojnë në QSAB;
- d) Të zgjedhë e të zgjidhet në organizmat drejtuese të sektorit dhe të QSAB-së, kur i plotëson kushtet e përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe nga kjo rregullore;
- ë) Të zbatojë detyrat e ngarkuara nga eprori, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me këtë rregullore dhe me rregulloret e institucionit.
- e) T'u përgjigjet me përpikëri detyrimeve administrative, duke marrë pjesë aktive në juri, komisione, borde e këshilla drejtues, në pozicione drejtimi dhe në grupe pune të ndryshme dhe merr honorar për punën ose për shërbimin e kryer në rastet kur e parashikon ligji.
- gj) Punonjësi shkencor gëzon liri të plotë akademike në shprehjen e mendimeve të tij; ai nuk mund të penalizohet në asnjë rast për qëndrimet e tij lidhur me tezat shkencore që mbron.

Neni 37

Mobiliteti ndërkombëtar i personelit akademik

Punonjësi shkencor gëzon të drejtën e udhëtimit dhe të qëndrimit jashtë shtetit për arsye pune, me mjete financiare të siguruara nga ai vetë, ose me mbështetje financiare të institucionit në kuadër të projekteve shkencore apo të kualifikimit të thelluar shkencor.

Të drejtat dhe detyrimet e në lidhje me këtë lëvizje parashikohen në statutin e UE "A.Xhuvani" dhe rregulloren e FSHH-së

1. Çdo lëvizje e personelit akademik jashtë shtetit për arsye pune, bëhet me miratim të dekanit të FSHH-së dhe/ose të Drejtorit të QSAB-së, sipas këtyre termave:

- a) Për pjesëmarrjen në konferenca dhe veprimtari ndërkombëtare, punonjësi detyrohet në çdo rast të njoftojë titullarin të paktën dy muaj përpara datës së nisjes;
- b) Në rastet kur lëvizja e personelit akademik jashtë shtetit parashikohet për më shumë se dy javë, po jo më shumë se tre muaj pa ndërprerje, punonjësi detyrohet të nënshkruajë një kontratë largimi të përkohshme me dekanin dhe me Drejtorin e QSAB-së.

2. Punonjësi shkencor, mbi bazën e një marrëveshjeje me institucione homologe dhe të kontratës me drejtuesin e institucionit, për kualifikimin shkencor vetjak ose për veprimtaritë kërkimore deri tremujore që ai kryen në kuadrin e angazhimit të tij shkencor në QSAB, gëzon të drejtën për mbështetje financiare, duke përfutur pagën përkatëse nga institucioni sipas dispozitave në fuqi. Në raste të veçanta, po të tejkalohet periudha tremujore, punonjësit i ruhet vendi i punës sipas dispozitave ligjore e financiare në fuqi dhe sipas parashikimit në kontratë.

3. Me rekomandim të bordit drejtues të qendrës dhe/ose përgjegjësit të departamentit, punonjësit shkencorë mund t'i krijohen mundësi për të ndjekur programe dhe kurse të ndryshme kualifikimi të thelluar jashtë vendit, që lidhen me fushën e studimeve të tij, për afate kohore deri në një vit. Modalitetet e largimit të përkohshëm nga institucioni parashikohen në një kontratë të posaçme.

Neni 38

Masat disiplinore

1. Llojet e masave disiplinore janë:

- a) Tërheqje e vëmendjes;
- b) Vërejtje me shkrim;
- c) Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna;
- ç) Pezullim nga detyra;
- d) Largim nga puna.

2. Masat disiplinore i propozohen Drejtorit të QSAB-së, përkatësisht nga përgjegjësi i seksionit, me përjashtim të rasteve -a dhe -b të pikës 1 të këtij neni, që janë kompetencë e njësisë drejtuese përkatëse.

3. Rastet për të cilat merret masa disiplinore përcaktohen në rregulloren e QSAB.

4. Largimi nga puna i punonjësit shkencor, ose hedhja në konkurrim e postit të mbajtur prej tij, bëhet nga Drejtori i QSAB, me propozim të bordit drejtues të qendrës, të përgjegjësit të sektorit, në rastet kur punonjësi:

- a) ka kryer shkelje të rënda të etikës akademike, të Statutit të UE A.Xhuvani dhe të Rregullores së QSAB-së;
- b) ka kryer shkelje të rënda të Kodit të Punës.

Neni 39
Konflikti i interesave

1. Punonjësit e QSAB-së dhe të emëruarit e jashtëm duhet të njohin rastet ligjore të konfliktit të interesit dhe t'i deklarojnë paraprakisht në organin që i emëron ose i zgjedh.
2. Gjatë ushtrimit të funksionit ose të detyrës, punonjësi duhet t'i parandalojë konfliktet e interesit. Kur kjo është e pamundur, ai bën deklaratë me shkrim para organit ose autoritetit përkatës drejtues ose jep dorëheqje.

KREU IX MËNYRAT E FINANCIMIT

Neni 40
Hartimi i buxhetit

1. Secili sektor brenda datës 15 korrik, paraqet në Drejtorinë e QSAB-së projektbuxhetin e tij për vitin pasardhës.
2. Projektbuxheti i QSAB-së hartohet nga Drejtoria e QSAB-së, mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga sektorët e nga njësitë e tjera, dhe miratohet nga bordi drejtues, pasi merr pëlqimin prej Këshillit të Fakultetit.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 42
Stema

1. QSAB ka për simbol të saj stemën e paraqitur sipas modelit 2 në faqen pasardhëse.
2. QSAB ka për logo figurën e paraqitur sipas modelit 3 në faqen pasardhëse.
3. Sektorët e veçantë kanë vulën e tyre dhe i propozojnë bordit drejtues për miratim simbolet e tyre.

Neni 43
Miratimi i rregulloreve

1. Brenda tre muajve nga miratimi i hapjes së QSAB-së, Këshilli i Fakultetit miraton Rregulloren e QSAB-së.
2. Rregulloret e tjera të brendshme, si të sektorëve shkencorë, të njohura me këtë rregullore, paraqiten për miratim në Drejtorinë e QSAB-së, brenda një muaji nga miratimi i Rregullores së QSAB-së.

Neni 44

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me shpalljen e saj nga Drejtori i QSAB-së, pas miratimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, apo të nesërmen e mbarimit të afatit 2-mujor për t'u shprehur Ministri.

KËSHILLI i FAKULTETIT TË FSHH-së

KRYETARI

Prof. dr. Roland Gjini